



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

STUDIM

KRAHASIMOR MIDIS LIGJIT NR. 61/2012 “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE DIREKTIVËS SË KËSHILLIT (BE) 2020/262 DATË 19 DHJETOR 2019 I CILI VENDOS REGJIMIN E PËRGJITHSHËM TË AKCIZËS

KY STUDIM KRAHASIMOR MIDIS LIGJIT NR. 61/2012 “PËR AKCIZAT NE R.SH” dhe DIREKTIVËS SË KESHILLIT (BE) 2020/262 U PERGATIT NGJA QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJJE	3
II. ANALIZË KRAHASUESE STRUKTURE DHE E PËRMBAJTJES	5
2.1. Fusha e zbatimit	5
2.2. Sistemet digjitale të mbikëqyrjes (EMCS).....	5
2.3. Regjimi i pezullimit të akcizës.....	5
2.4. Operatorët ekonomikë (subjekt kontrolli).....	6
2.5. Dokumentacioni i akcizës	6
2.6. Rimbursimi dhe përjashtimet.....	6
2.7. Lëvizja e mallrave të hedhura për konsum	6
III. SHEMAJ PRAKTIKË TË NDRYSHIMEVE KRYESORE	7
TABELË KRAHASUESE TEMATIKE.....	8
IV. KRAHASIM NEN PËR NEN SIPAS FUSHAVE	9
4.1 Neni 1 i Direktivës (BE) 2020/262 krahasuar me nenin 1 të Ligjit Nr. 61/2012	9
4.2 Neni 3 i Direktivës (BE) 2020/262 krahasuar me nenin 2 të Ligjit Nr. 61/2012	11
4.3 Nenit 4, 5 të Direktivës (BE) 2020/262 krahasuar me pikën 11 të nenit 2 të Ligjit Nr. 61/2012.....	13
4.4 Neni 6 i Direktivës 2020/262 krahasuar me nenin 4 të ligjit 61/2012	14
4.5 Krahasimi i Nenit 7 të Direktives 2020/262 me Nenin 9 të Ligjit Nr. 61/2012	17
4.6 Krahasimi nenit 10 të Direktivës 2020/262 dhe Nenit 13, 14 të Ligjit Nr. 61/2012	19
4.7 Krahasimi i Nenit 11 të Direktives 2020/262 me Nenin 10 të Ligjit Nr. 61/2012	21
4.8 Krahasimi ndërmjet nenit 12 të Direktivës 2020/262 dhe pikës 5, neni 10 të Ligjit Nr. 61/2012	23
4.9 Krahasimi ndërmjet nenit 13 të Direktivës 2020/262 dhe Nenit 12 të Ligjit Nr. 61/2012.....	25
4.10 Krahasimi midis Neni 14 i Direktivës 2020/262 të BE-së dhe Nenit 19 i Ligjit Nr. 61/2012	27
4.11 Krahasimi midis Neni 15 i Direktivës 2020/262 të BE-së dhe Nenit 20 i Ligjit Nr. 61/2012 të Shqipërisë.....	28
4.12 Krahasimi midis Neni 16 i Direktivës 2020/262 të BE-së dhe Nenit 30 i Ligjit Nr. 61/2012 të Shqipërisë.....	30
4.13 Krahasim midis NENIT 18 të Direktivës (BE) 2020/262 dhe Nenit 32 të Ligjit nr. 61/2012, në lidhje me pritësin e regjistruar (registered consignee)	35
4.14 Krahasimi midis nenit 19 të Direktivës 2020/262/BE dhe Nenit 33 të Ligjit Nr. 61/2012 të Shqipërisë.....	37
V. PËRMBLEDHJE DHE PËRFUNDIME KRYESORE	39
VI. QASJA NDAJ DIREKTIVËS 2020/262	41
BIBLIOGRAFIA	47

I. HYRJE

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian (SKZHIE) 2022-2030, ku përshkruhet vizioni dhe objektivat strategjike Kombëtare, përcakton se qëllimi parësor strategjik është integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në Qershor të vitit 2006 Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim – Asociimit (MSA), e cila hyri tërësisht në fuqi në Prill të vitit 2009¹. Pika 1 e nenit 70 të MSA përcakton *“Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.”*

Nga Qershori i vitit 2014, Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Evropian. Marrja e statusit të vendit kandidat shënon një hap shumë të rëndësishëm në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE, duke reflektuar ecurinë e reformave të ndërmarra dhe i hapurrrugë procesit të plotë të aderimit të vendit në Bashkimin Evropian.

Aktualisht Shqipëria, pas hapjes së bisedimeve për përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian është në fazën e intensifikimit të përpjekjeve për t’u bërë pjesë e Bashkimit Evropian. Për qëllime të procesit të negociatave, *acquis* i BE-së ndahet në 35 kapituj negociues (fusha politikash).

Kapitulli 16, trajton *acquis* për tatimet dhe kërkon harmonizimin e legjislacionit tatimor të Shteteve Anëtare (dhe vendeve aderuese) me atë të BE-së kryesisht në fushën e tatimeve indirekte, përkatësisht për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe detyrimet e akcizës (Akciza). Akciza, si një taksë indirekte që zbatohet mbi produktet e akcizës, të prodhuara dhe të importuara, që hidhen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë, trajtohet me ligjin nr. 61/2012 *“PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”* i ndryshuar.²

¹ <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2006/87/3e565b9e-375a-4884-9897-6e75854aa0c4>

² <https://www.qbz.gov.al/previeë/c09983ba-d28c-42d2-9548-3082e84e4433/cons/20240821>

Ky ligj dhe posaçërisht Titulli I, është përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor 2008 “Lidhur me masat e përgjithshme mbi taksën e akcizës, e cila shfuqizon direktivën 92/12/KE”³.

Ndërkohë, të ardhurat nga produktet e akcizës janë zëri kryesor në totalin e të ardhurave doganore. Konkretisht të ardhurat neto nga produktet e akcizës zënë 44% të totalit të të ardhurave doganore të realizuara përgjatë 2024 (101,769,243 nga 229,519,901).

Si rrjedhojë duke ju referuar së pari procesit të integritetit dhe së dyti, por jo nga rëndësia, peshës që ka Akciza për gjenerimin e të ardhurave buxhetore, del e qartë rëndësia e këtij studimi i cili mundet t’i paraprijë ndryshimeve që mundet të dalin të nevojshme dhe duke patur në vëmendje parimet e politikës të cilat duhet të udhëheqin zhvillimin e sistemeve tatimore ku përfshihen neutraliteti, efikasiteti, siguria dhe thjeshtësia, efektiviteti, drejtësia dhe fleksibiliteti.

³ Excise duties - Common provisions - Movement regime 32008L0118 Council Directive 2008/118/EC of 16 December 2008 concerning the general arrangements for excise duty and repealing Directive 92/12/EEC (OJ L 9, 14.1.2009, p. 12–30) <http://data.europa.eu/eli/dir/2008/118/2014-01-01>

II. ANALIZË KRAHASUESE STRUKTURE DHE E PËRMBAJTJES

Sikurse përmendëm Ligji shqiptar nr. 61/2012 "Për akcizën në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, (ligji nr. 61/2012) ka përafruar Direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor 2008 "Lidhur me masat e përgjithshme mbi taksën e akcizës, e cila shfuqizon direktivën 92/12/KE" e cila është shfuqizuar përmes Direktivës (BE) 2020/262 (Direktiva 2020/262) e njohur si "Direktiva e re e Akcizës".

Prandaj së pari del e nevojshme të bëhet një analizë krahasuese strukturore dhe e përmbajtjes. Kjo analizë fokusohet në pikat ku direktiva e BE-së sjell ndryshime thelbësore krahasuar me ligjin shqiptar aktual.

2.1. Fusha e zbatimit

- Direktiva 2020/262: Përfshin produkte të harmonizuara akcize (alkooli, duhani, karburantet) dhe përcakton rregullat për lëvizjen dhe mbikëqyrjen brenda BE.
- Ligji 61/2012: Përfshin po ashtu produktet akcize, por nuk ka dispozita që lidhen me lëvizjen ndërkombëtare të mallrave në BE, për shkak të statusit jo-anëtar të Shqipërisë.

Ndryshimi: Direktiva ka fokus edhe në tregtinë ndërshtetërore brenda BE-së, gjë që mungon në ligjin shqiptar.

2.2. Sistemet digjitale të mbikëqyrjes (EMCS)

- Direktiva 2020/262: Parashikon përdorimin e detyrueshëm të EMCS (Excise Movement and Control System) për lëvizjen e mallrave nën regjim pezullimi dhe pas vitit 2023, edhe për mallrat që janë hedhur për konsum.
- Ligji 61/2012: Nuk e përfshin EMCS; kontrolli bëhet përmes dokumentacionit fizik dhe sistemit kombëtar të monitorimit.

Ndryshimi: BE kërkon digjitalizim të plotë dhe ndjekje në kohë reale të mallrave të akcizës.

2.3. Regjimi i pezullimit të akcizës

- Direktiva 2020/262: Jep detaje të sakta për fillimin, përfundimin dhe ndërprerjen e regjimit të pezullimit.
- Ligji 61/2012: Përmend regjim pezullimi, por mungojnë detaje teknike të zbatimit.

Ndryshimi: Direktiva ofron rregullim më të detajuar dhe të harmonizuar për këtë regjim.

2.4. Operatorët ekonomikë (subjekt kontrolli)

- Direktiva 2020/262: Kategoritë: operator të autorizuar, marrës të regjistruar, marrës të përkohshëm, etj.
- Ligji 61/2012: Ka disa kategori të ngjashme, por nuk përfshin terminologjinë dhe kategorizimin sipas direktivës.

Ndryshimi: BE ka një strukturim më të detajuar të subjekteve që operojnë me mallra akcize.

2.5. Dokumentacioni i akcizës

- Direktiva 2020/262: Kërkon dokument elektronik të akcizës (e-AD për pezullim dhe e-SAD për mallrat e konsumuara).
- Ligji 61/2012: Bazohet në dokumete fizike dhe formate elektronike vendore.

Ndryshimi: BE shkon drejt dokumenteve digjitale për transparencë dhe gjurmueshmëri.

2.6. Rimbursimi dhe përjashtimet

- Direktiva 2020/262: Parashikon qartë rastet kur rimbursohet akciza (p.sh. në rast dëmtimi, eksporti, përdorim për qëllime të veçanta).
- Ligji 61/2012: Përmend rimbursim, por nuk ka të njëjtën qartësi dhe ndarje si direktiva.

Ndryshimi: Direktiva ka më shumë transparencë dhe garanci për operatorët ekonomikë në çështje të rimbursimit.

2.7. Lëvizja e mallrave të hedhura për konsum

- Direktiva 2020/262: E zgjeron përdorimin e EMCS edhe për mallrat që janë tashmë të konsumueshme në një shtet dhe lëvizin në një tjetër.
- Ligji 61/2012: Nuk e përmban këtë koncept – fokusohet vetëm brenda territorit shqiptar.

Ndryshimi: Kjo është **risi në BE**, e cila nuk zbatohet në Shqipëri për shkak të statusit jashtë-BE.

III. SHEMBUJ PRAKTIKË TË NDRYSHIMEVE KRYESORE

Këta shembuj prezantojnë se si ndryshon qasja ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë.

Shembull 1 – Lëvizja e mallrave nën regjim pezullimi (EMCS)

Skenari BE – sipas Direktivës 2020/262

Një depo në Gjermani dërgon 10,000 litra verë në Itali. Lëvizja bëhet nën regjim pezullimi të akcizës.

- EMCS gjeneron dokumentin elektronik të akcizës (e-AD).
- Gjatë rrugës, autoritetet doganore mund të verifikojnë mallin në kohë reale.
- Kur malli mbërrin, marrësi konfirmon marrjen në sistem dhe EMCS mbyll procesin.

Skenari Shqipëri – sipas Ligjit 61/2012

Një magazinë në Tiranë dërgon mall me akcizë në Shkodër.

- Lëvizja kryhet me Formate elektronike vendore shoqëruar edhe me formular fizik pezullimi.
- Sistemi elektronik për ndjekjen në kohë reale nuk është i qartë.
- Konfirmimi bëhet fizikisht përmes dokumenteve.

Dallimi: BE përdor sistem elektronik me transparencë të plotë; Shqipëria ende bazohet në dokumentacion fizik.

Shembull 2 – Rimbursimi i akcizës për mallin e dëmtuar gjatë transportit

Skenari BE

Një kamion me cigare nën regjim pezullimi përplaslet dhe mallrat dëmtohen përpara se të mbërrijnë në destinacion.

- Sipërmarrësi paraqet kërkesë rimbursimi me prova digjitale (raport policie, raport sigurimi, EMCS).
- Autoritetet pranojnë rimbursimin pasi mallrat nuk janë konsumuar.

Skenari Shqipëri

Një kamion me cigare përplaslet. Sipërmarrësi kërkon rimbursim, por:

- Nuk ka proces të qartë për raportimin digjital.
- Procedura është më e gjatë dhe e paqartë në ligj.
- Vlerësimi është subjektiv dhe me diskrecion administrativ.

Dallimi: BE ka procedurë të harmonizuar dhe të standardizuar për rimbursim; në Shqipëri procedura është pak e formalizuar dhe më e vështirë për operatorin.

Shembull 3 – Lëvizja e mallrave të hedhura për konsum nga një shtet BE në një tjetër

Skenari BE (pas 13.02.2023)

Një supermarket në Francë blen verë nga një shitës në Itali.

- Mallrat janë hedhur për konsum në Itali, por lëvizin në Francë.
- Lëvizja bëhet përmes EMCS edhe pse akciza është paguar në Itali.
- Në Francë paguhet sërish akcizë, ndërsa ajo e Italisë mund të rimbursohet.

Skenari Shqipëri

E pamundur – Shqipëria nuk ka lëvizje të mallrave të akcizës që janë hedhur për konsum në një shtet tjetër, për shkak se nuk është pjesë e BE-së.

Dallimi: Kjo procedurë është ekskluzivisht brenda BE-së. Shqipëria nuk mund t'a aplikojë për shkak të statusit të saj.

TABELË KRAHASUESE TEMATIKE

Tema	Direktiva (BE) 2020/262	Ligji shqiptar nr. 61/2012	Dallimi kryesor
Fusha e zbatimit	Mallra të harmonizuara akcize + tregti brenda BE	Vetëm brenda Shqipërisë	BE përfshin qarkullimin ndër-shtetëror
Sistemi i lëvizjes	EMCS elektronik për çdo lëvizje	Sistem elektronik vendor dhe regjistra manualë	BE kërkon digjitalizim dhe gjurmueshmëri në kohë reale
Regjimi i pezullimit	Përcaktim i qartë i fillimit dhe përfundimit të pezullimit	Përmendet në mënyrë të përgjithshme pa shumë detaje	BE detajon me akte zbatuese dhe EMCS
Operatorët ekonomikë	Klasifikim i detajuar (depo mbajtës, marrës i regjistruar, i përkohshëm)	Pa ndarje shumë të qartë dhe jo e harmonizuar	Struktura e BE është më e kategorizuar dhe funktionale
Dokumentacioni i akcizës	e-AD / e-SAD (elektronik)	Formularë, autorizime	BE përdor vetëm dokumente elektronike
Rimbursimi i akcizës	Procedura të qarta dhe të unifikuara për humbje, dëmtime apo eksport	Parashikime të kufizuara dhe jo të standardizuara	BE ka transparencë dhe afate të përcaktuara
Lëvizja e mallrave të konsumit	E lejuar nëpërmjet EMCS pas 2023	Jo e përfshirë	Shqipëria nuk e aplikon pasi nuk është pjesë e BE

IV. KRAHASIM NEN PËR NEN SIPAS FUSHAVE

Krahasimi më poshtë fokusohet në disa prej neneve më të rëndësishme, duke vendosur përballë nenin e Direktivës dhe nenin përkatës në Ligjin shqiptar.

4.1 Neni 1 i Direktivës (BE) 2020/262 krahasuar me nenin 1 të Ligjit Nr. 61/2012

Neni 1 i Direktivës (BE) 2020/262 – Fusha e zbatimit

Përmbajtja:

Ky nen përcakton fushën e zbatimit të direktivës. Ai rregullon:

- Regjimin e përbashkët të akcizës për mallrat akcizë të harmonizuara, si:
 - Alkooli dhe pijet alkoolike
 - Produktet e duhanit
 - Produktet e energjisë dhe energjia elektrike
- Aplikohet për:
 - Prodhimin
 - Ruajtjen
 - Lëvizjen (brenda dhe ndërmjet shteteve anëtare)
 - Konsumin e këtyre mallrave brenda BE-së.
- Direktiva vendos rregulla të përbashkëta që duhet të zbatohen në të gjitha shtetet anëtare të BE-së për të garantuar funksionimin e tregut të përbashkët.

Neni 1 i Ligjit Shqiptar nr. 61/2012 – Fusha e zbatimit

Përmbajtja:

Ky nen përkufizon qëllimin e ligjit si:

- Rregullimi i marrëdhënieve që lidhen me:
 - Prodhimin
 - Importin
 - Magazinimin
 - Shitjen dhe konsumimin e mallrave që i nënshtrohen akcizës brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Ligji rregullon:
 - Procedurat për vendosjen dhe mbledhjen e akcizës
 - Kriteret për regjistrimin e subjekteve
 - Kontrollin administrativ të veprimtarisë me mallrat e akcizës

Dallimet kryesore ndërmjet Nenit 1 të Direktivës dhe Nenit 1 të Ligjit shqiptar

Aspekti	Direktiva (BE) 2020/262 – Neni 1	Ligji shqiptar 61/2012 – Neni 1	Dallimi kryesor
Fusha gjeografike	Rregullon tregun e përbashkët të BE-së	Rregullon vetëm territorin shqiptar	BE synon qarkullim të lirë dhe të koordinuar ndërmjet shteteve anëtare
Lëvizja ndër-shtetërore	Përfshin lëvizjen ndërmjet shteteve anëtare (intra-BE)	Nuk e përmend lëvizjen ndërkombëtare (as me vendet fqinje)	Shqipëria nuk ka sistem të unifikuar për këtë lloj lëvizjeje
Mallrat e përfshira	Vetëm mallrat e akcizës së harmonizuar (alkool, duhan, energji)	Përfshin mallra të tjera të përcaktuara nga legjislacioni vendas	Ligji shqiptar mund të përfshijë produkte jo të harmonizuara nga BE
Objektivi kryesor	Harmonizimi i procedurave dhe rregullave për funksionimin e tregut	Mbledhja e të ardhurave dhe kontrolli fiskal i brendshëm	BE e vendos fokusin në integrimin ekonomik, Shqipëria të mbikëqyrja fiskale
Sistemi i aplikimit	Bazohet në harmonizim dhe bashkëpunim ndër-shtetëror	I bazuar në rregullime të brendshme dhe administratë doganore kombëtare	Shqipëria nuk aplikon sistem të koordinuar me vendet e tjera për akcizën

Përmbledhje

- Direktiva e BE-së (neni 1) vendos kuadrin ligjor për trajtimin e mallrave akcizë në një sistem të integruar ekonomik, duke përfshirë qarkullimin ndërshtetëror dhe zbatimin e standardeve të përbashkëta.
- Ligji shqiptar (neni 1) fokusohet në rregullimin e brendshëm dhe nuk trajton lëvizjen ndërkombëtare apo integrimin me sistemin e BE-së.

4.2 Neni 3 i Direktivës (BE) 2020/262 krahasuar me nenin 2 të Ligjit Nr. 61/2012

Neni 3 i Direktivës 2020/262 të BE-së: ***Përkufizimi i mallrave të akcizës***

Përmbajtja:

Ky nen përcakton kategoritë e mallrave që i nënshtrohen akcizës në Bashkimin Evropian:

- Produktet energjetike dhe energjia elektrike, sipas Direktivës 2003/96/EC.
- Alkooli dhe pijet alkoolike, sipas Direktivave 92/83/EEC dhe 92/84/EEC.
- Duhani i përpunuar, sipas Direktivës 2011/64/EU.

Gjithashtu, neni lejon që shtetet anëtare të vendosin taksa të tjera indirekte mbi mallrat e akcizës për qëllime specifike, për sa kohë që këto taksa janë në përputhje me rregullat tatimore të BE-së që zbatohen për Akcizën ose TVSH-në, për sa i përket përcaktimit të bazës tatimore, llogaritjes së taksës, ngarkimit dhe monitorimit të taksës, por jo përjashtimeve.

Neni 2 i Ligjit Nr. 61/2012 të Shqipërisë: ***Përkufizimi i mallrave të akcizës***

Përmbajtja:

Ky nen përcakton mallrat që i nënshtrohen akcizës në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë:

- **Produktet energjetike.**
- **Alkooli dhe pijet alkoolike.**
- **Duhani i përpunuar.**
- **Kafenë dhe zëvendësuesit e saj.**
- **Produkte të tjera, sipas përcaktimeve të mëtejshme në ligj.**

Dallimet kryesore ndërmjet Nenit 3 të Direktivës dhe Nenit 2 të Ligjit shqiptar

Aspekti	Neni 3 - Direktivës 2020/262 (BE)	Neni 2 - Ligji 61/2012 (Shqipëri)
Qëllimi	Përkufizon produktet që i nënshtrohen akcizës dhe vendos kuadrin e përgjithshëm për taksimin e tyre në BE.	Jep përkufizime të hollësishme ligjore për zbatimin e akcizës në Shqipëri, përfshirë rolet e operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve.
Produktet që i nënshtrohen akcizës	a) Produktet energjetike dhe energjia elektrike b) Alkooli dhe pijet alkoolike c) Duhani i përpunuar	a) Produktet energjetike b) Alkooli dhe pijet alkoolike c) Duhani dhe produktet e duhanit ç) Produkte të tjera (të përcaktuara nga ky ligj – p.sh., kafeja)
Përkufizime të operatorëve	Nuk jep përkufizime të detajuara për operatorët ekonomikë në këtë nen (ato trajtohen në nenet e tjera të direktivës).	Jep përkufizime të hollësishme për: depozitues të miratuar, pritës të regjistruar, dërgues të regjistruar, përdorues të përjashtuar, përfaqësues fiskal, magazinë fiskale etj.
Regjimi i pezullimit të akcizës	I përmendur në direktivë si regjim thelbësor që lejon lëvizjen dhe prodhimin pa pagesë akcize derisa mallrat të hidhen për konsum.	Përkufizohet saktësisht si regjim ku pezullohet pagesa e akcizës gjatë prodhimit, përpunimit, mbajtjes apo lëvizjes së mallrave.
Pullat fiskale dhe kodi i sigurisë	Nuk trajtohet në nenin 3 të direktivës (rregullohet në akte të tjera të BE-së).	Jep përkufizime të detajuara për pullën e akcizës, pullën fiskale dhe kodin e sigurisë.
Përjashtime	Neni 3 lejon që shtetet anëtare të vendosin taksa shtesë, për sa kohë janë në përputhje me rregullat e BE-së.	Ligji shqiptar ka kategori të veçanta si “përdorues i përjashtuar” (pika 15) që përfitojnë nga përjashtimet me autorizim.
Termi “akcizë”	Përkufizohet në kontekstin e sistemit të përbashkët të taksimit indirekt në BE.	Pika 2 e nenit 2: është taksë që aplikohet mbi produktet e akcizës që prodhohen ose importohen dhe hidhen për konsum në Shqipëri.

**4.3 Nenet 4 dhe 5 të Direktivës (BE) 2020/262 krahasuar me pikën 11 të nenit 2 të
Ligjit Nr. 61/2012**

Ligji Nr. 61/2012 – *Neni 2, pika 11*

Përmbajtja:

“Territor” është territori doganor, sipas përcaktimit përkatës në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.”

Ky përkufizim i referohet territorit brenda të cilit autoritetet shqiptare doganore ushtrojnë kompetencën për mbledhjen e akcizës, sipas rregullave kombëtare doganore.

Direktiva 2020/262/BE Neni 4 – *Fusha territoriale e zbatimit*

Përmbajtja:

1. “Kjo direktivë zbatohet për territorin e Bashkimit, me përjashtimet e përmendura në nenin 5.”

Neni 5 – Përjashtimet territoriale

Ky nen liston **territoret e shteteve anëtare** që janë **të përjashtuara** nga zbatimi i kësaj direktive për arsye specifike (p.sh., ishujt Channel, territore të largëta franceze, enklava spanjolle etj.).

KRAHASIMI

Elementi	Ligji shqiptar (Neni 2, pika 11)	Direktiva 2020/262 (Nenet 4 & 5)
Territori i zbatimit të ligjit	Territori doganor i Shqipërisë	Territori doganor i Bashkimit Evropian (me disa përjashtime)
Referenca ligjore	Kodin Doganor të Shqipërisë	Vetë direktiva + përjashtimet në nenin 5
Qasja	Nacionale – fokusuar vetëm te juridiksioni shqiptar	Zbatueshmëri në të gjithë BE-në me përjashtime
Funksioni	Përcakton vendin ku zbatohet akciza nga autoritetet shqiptare	Përcakton shtetet dhe territoret ku zbatohet regjimi i përbashkët i akcizës në BE

KONKLUZION

- Në Shqipëri, territori përcaktohet me referencë në Kodin Doganor, dhe zbatohet vetëm brenda kufijve kombëtarë.
- Në BE, territori i zbatimit është i harmonizuar për të gjitha shtetet anëtare, me përjashtime të qarta që kanë natyrë politike, historike ose gjeografike (neni 5).

Në thelb, të dy përcaktimet kanë të njëjtin funksion ligjor – të qartësojnë hapësirën gjeografike ku zbatohen rregullat e akcizës – por në dy nivele të ndryshme të të drejtës: kombëtare dhe evropiane.

5.4 Neni 6 i Direktivës 2020/262 krahasuar me nenin 4 të ligjit 61/2012

Neni 6 i Direktivës- *Ngjarja që sjell lindjen e detyrimit, koha dhe vendi i detyrimit, shkatërrimi dhe humbjet e pakthyeshme*

Përmbajtja:

1. Ngjarja e tatueshme që sjell lindjen e detyrimit dhe koha e pagesës së akcizës:

- Produkti i akcizës i nënshtrohet tatimit të akcizës në momentin e:
 - Prodhimit, përfshirë nxjerrjen e tij, brenda territorit të Bashkimit Evropian.
 - Importimit të tij ose hyrjes së tij të jashtëligjshme në territorin e Bashkimit.

2. Koha dhe vendi i pagesës së akcizës:

- Akciza bëhet e detyrueshme në momentin dhe në shtetin anëtar kur produkti hidhet për konsum.

3. Përkufizimi i "hedhje për konsum":

- Hedhja për konsum mund të ndodhë në disa situata, përfshirë:
 - Dalja e produkteve nga një regjimi pezullimi të akcizës (p.sh. nga një regjimi pezullues doganor).
 - Mbajtja dhe ruajtja e produkteve jashtë një regjimi pezullimi të akcizës ku akciza nuk është paguar.
 - Prodhimi dhe përpunimi i produkteve jashtë regjimit të pezullimit.
 - Importimi i produkteve, përveç atyre që janë vendosur menjëherë në një regjim pezullimi të akcizës.

4. Shkatërrimi dhe humbja e produkteve të akcizës:

- Shkatërrimi total ose humbja e pa riparueshme e produkteve të akcizës, për shkak të forcës madhore ose rrethanave të papritura, nuk konsiderohet si një lirimi për konsum.
- Humbjet e pjesshme që ndodhin gjatë transportit ndërmjet shteteve anëtare të BE-së që janë nën një regjim pezullues të akcizës, konsiderohen si të paqena për konsum nëse humbja është nën pragun e zakonshëm të humbjes.

5. Dëmi dhe humbjet e pa riparueshme:

- Shkatërrimi total ose humbja e pa riparueshme duhet të provohet nga autoritetet përkatëse të shtetit anëtar.
- Kur një humbje e tillë konfirmohet, garancia e dhënë mund të lirohet pjesërisht ose plotësisht.

Neni 4 i ligjit 61/2012: *Lindja e detyrimit të akcizës*

Përmbajtja:

Momenti dhe vendi i lindjes së detyrimeve të akcizës

Përkufizimi i "hedhjes për konsum" dhe momentet e lidhura me lindjen e detyrimit të akcizës:

1. **Lindja e detyrimit të akcizës:**
 - Detyrimi për të paguar akcizën lind në momentin e hedhjes për konsum të mallrave të akcizës në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. **Përkufizimi i "hedhjes për konsum":**
 - Dalja e mallrave nga një regjim pezullues i detyrimeve, përfshirë daljet e parregullta.
 - Mbajtja e mallrave jashtë një regjimi pezullues, nëse akciza nuk është paguar sipas ligjit.
 - Prodhimi i mallrave jashtë regjimit pezullues, përfshirë prodhimin e parregullt.

- Importi i mallrave, përfshirë importet e parregullta, përveç kur mallrat futen menjëherë në një regjim pezullues.

3. Momente të tjera të hedhjes për konsum:

- Dërgimi i mallrave nga një depozitues i miratuar drejt një personi që nuk është i autorizuar për të pritur mallra akcize nën regjimin pezullues.
- Prodhimi i mallrave përtej sasive të parashikuara.
- Konsumimi i mallrave për qëllime vetjake në ambientet e magazinës fiskale.
- Krijimi i humbjeve ose firos së mallrave gjatë periudhës së pezullimit të detyrimeve, me kusht që humbjet të provohen si pasojë e forcës madhore ose karakteristikave të natyrshme të mallrave.
- Ditën kur autorizimi i depozituesit të miratuar ose i përjashtimit nga detyrimi i akcizës pushon.

KRAHASIMI

Elementi	Ligji Nr. 61/2012 – Neni 4	Direktiva 2020/262 – Neni 6
Lindja e detyrimit të akcizës	Detyrimi lind në momentin e hedhjes për konsum të mallrave në territor.	Detyrimi lind në momentin e prodhimit, importimit ose hedhjes për konsum të mallrave të akcizës.
Përkufizimi i "hedhjes për konsum"	Hedhja për konsum përfshin daljen e mallrave nga regjimi pezullues, mbajtjen jashtë regjimit pezullues, prodhimin dhe importin e parregullt.	Hedhja për konsum përfshin daljen nga regjimi pezullues, mbajtjen jashtë regjimit pezullues, dhe prodhimin jashtë regjimit pezullues.
Përkufizimi i "daljes për konsum"	Dalja për konsum mund të ndodhë edhe për mallrat që dalin nga regjimi pezullues, përfshirë rastet e daljes së parregullt.	Dalja për konsum ndodh kur mallrat dalin nga regjimi pezullues, përfshirë rastet e daljes së parregullt.
Mbajtja e mallrave jashtë regjimit pezullues	Mbajtja e mallrave jashtë regjimit pezullues, ku akciza nuk është paguar, konsiderohet hedhje për konsum.	Mbajtja e mallrave jashtë regjimit pezullues pa paguar akcizën është gjithashtu një çlirim për konsum.
Humbja dhe firot e mallrave	Humbjet dhe firot gjatë periudhës së pezullimit nuk konsiderohen hedhje për konsum, përveçse në raste force madhore ose humbjeve të natyrshme të mallrave.	Humbjet e mallrave gjatë regjimit pezullues nuk janë hedhje për konsum, përveçse nëse ato janë shkaktuar nga forcë madhore ose nga karakteristikat e natyrshme të mallrave.

KONKLUZION

- **Ngjarja e tatueshme që sjell lindjen e detyrimit:** Të dy sistemet ligjore janë të ngjashme në përkufizimin e momentit të lindjes së detyrimit të akcizës, i cili ndodh kur mallrat dalin për konsum ose kur ndodhin shkelet e regjimit pezullues.
- **Përkufizimi i "hedhjes për konsum":** Të dyja aktet përfshijnë daljen e mallrave nga regjimi pezullues dhe prodhimin apo importin e parregullt si ngjarje që ngrenë detyrimin e akcizës.
- **Mbajtja e mallrave jashtë regjimit pezullues:** Të dyja legjislacionet e konsiderojnë këtë si një ngjarje që krijon detyrimin e akcizës.
- **Humbjet dhe frot:** Të dyja ligjet mundësojnë që humbjet dhe frot të mos konsiderohen hedhje për konsum, përveçse në rastet e forcës madhore ose humbjeve natyrale të lidhura me karakteristikat e mallrave.

Në thelb, të dyja sistemet ligjore ndjekin një qasje të ngjashme për të përcaktuar momentin e lindjes së detyrimit të akcizës, duke u përqëndruar te ngjarjet që ndodhin jashtë regjimit pezullues dhe kërkojnë një trajtim të veçantë për shkatërrimet dhe humbjet e mallrave.

4.5 Krahassimi i Nenit 7 të Direktives 2020/262 me Nenin 9 të Ligjit Nr. 61/2012

Direktiva 2020/262 - Neni 7: *Personi që është përgjegjës për pagesën e akcizës*

Përmbajtja:

1. Personi përgjegjës për pagesën e akcizës:

- Neni 7 i Direktives përcakton se personat përgjegjës për pagesën e akcizës janë individët që janë të përfshirë në heqjen e mallrave nga regjimi i pezullimit të detyrimeve të akcizës dhe ata që janë të lidhur me ndodhitë e parregullta, siç janë dalja e parregullt e mallrave nga një depozitë e miratuar ose lëvizjet e mallrave pa pagesën e duhur të akcizës.
 - Për mallrat e lëshuara (përfshirë edhe të lëshuara në mënyrë të parregullt), ata që janë të lidhur me daljen ose dërgimin e mallrave, si depozituesit e miratuar, dërguesit të regjistruar dhe çdo individ tjetër që është i përfshirë në këtë proces, janë të përgjegjshëm.
 - Për mbajtjen dhe magazinimin e mallrave, personi që i mban ose i ruan mallrat është i përgjegjshëm.
 - Për prodhimin dhe përpunimin e mallrave të akcizës, individët që janë të përfshirë në këtë proces janë të përgjegjshëm.
 - Për importimin ose hyrjen e parregullt të mallrave, deklaruesi ose individi tjetër që është i lidhur me këtë veprim është përgjegjës për pagesën e akcizës.

- Kur disa persona janë të përgjegjshëm për pagesën e të njëjtit detyrim akcize, ata do të mbajnë një përgjegjësi të përbashkët dhe të ndërsjellë për pagesën.

Ligji Nr. 61/2012 - Neni 9: Personi që është përgjegjës për pagesën e akcizës
Përmbajtja:

1. Personi përgjegjës për pagesën e akcizës:

- Në Ligjin Nr. 61/2012, neni 9 përcakton se personi që është përgjegjës për pagesën e akcizës është depozituesi i miratuar, pritësi i regjistruar, dhe çdo person tjetër që është i përfshirë në hedhjen e mallrave për konsum.
- Për mallrat që janë hedhur për konsum nga një depozitues i miratuar ose një person i regjistruar, kjo ka të bëjë me detyrimin për pagesën e akcizës.
- Për situatat kur ka parregullsi, siç janë daljet e parregullta të mallrave nga një depozitë ose lëvizjet jashtë një regjimi pezullimi, depozituesi i miratuar, si dhe të tjerët që janë të përfshirë, do të jenë të përgjegjshëm për pagesën e akcizës.

2. Përgjegjësia e përbashkët dhe e ndërsjellë:

- Në rast se disa individë janë të përfshirë në detyrimin e pagesës së akcizës, përgjegjësia është e përbashkët dhe e ndërsjellë, pra të gjithë personat që kanë lidhje me lëshimin e mallrave për konsum janë të detyruar të paguajnë akcizën.

KRAHASIMI

Elementi	Direktiva 2020/262 – Neni 7	Ligji Nr. 61/2012 – Neni 9
Personi përgjegjës për pagesën e akcizës	Personi përgjegjës është ai që përfshihet në lëvizjen, prodhimin, magazinimin, importimin ose lëshimin e mallrave të akcizës dhe që shkakton një detyrim për akcizën.	Personi përgjegjës për pagesën e akcizës është depozituesi i miratuar, pritësi i regjistruar , dhe çdo person tjetër i përfshirë në lëshimin e mallrave për konsum.
Parregullsitë dhe përgjegjësia	Përgjegjësia është e zbatueshme dhe për parregullsitë në lëvizjet e mallrave, si daljet e parregullta ose prodhimi i parregullt.	Po ashtu, përgjegjësia aplikohet për daljet e parregullta të mallrave dhe shkeljet që ndodhin gjatë periudhës së pezullimit të detyrimeve të akcizës.
Përgjegjësia e përbashkët dhe e ndërsjellë	Përgjegjësi e përbashkët dhe e ndërsjellë për pagesën e akcizës është	Përgjegjësi e përbashkët dhe e ndërsjellë për pagesën e akcizës aplikohet për çdo individ që është i

Elementi	Direktiva 2020/262 – Neni 7	Ligji Nr. 61/2012 – Neni 9
	e detyrueshme kur disa individë janë të përfshirë në detyrimin për akcizën.	përfshirë në hedhjen e mallrave për konsum.
Përfshirja e autoriteteve dhe veprimeve të tjera	Autorizohet garancia për pagesën e akcizës dhe mundësia e ndëshkimit në rastin e parregullsive.	Garancia për pagesën e akcizës dhe mundësitë e sanksioneve janë gjithashtu të përfshira për rastet kur ka parregullsi.

KONKLUZION

Në të dyja legjislacionet, Direktiva 2020/262 dhe Ligji Nr. 61/2012, përgjegjësia për pagesën e akcizës mbështetet te individët dhe subjektet që janë të përfshirë në lëvizjen, prodhimin, magazinimin, dhe importimin e mallrave të akcizës, duke përfshirë edhe rastet e parregullsive. Të dy ligjet përfshijnë mundësinë e përgjegjësisë të përbashkët dhe të ndërsjellë për detyrimin e pagesës së akcizës, duke theksuar rëndësinë e menaxhimit të rregullt dhe të përcaktuar të detyrimeve të akcizës për çdo person që përfshihet në këto veprime.

4.6 Krahasoni nenit 10 të Direktivës 2020/262 dhe nenit 13, 14 të Ligjit Nr. 61/2012 mbi rimbursimin dhe shuarjen e detyrimeve të akcizës

Ky krahasim sjell një pasqyrë të qartë të ngjashmërive dhe dallimeve konceptuale dhe procedurale midis sistemit të BE-së dhe atij shqiptar.

Direktiva 2020/262 – Neni 10 Rimbursimi dhe shuarja e detyrimit të akcizës

Përmbajtja:

- **Fushëveprimi:** Lejon rimbursimin ose shuarjen e akcizës për mallra që janë hedhur për konsum, me kërkesë të personit të interesuar, në situata të përcaktuara nga shteti anëtar dhe me kushte të vendosura për të parandaluar abuzimin dhe evazionin.
- **Mbështetja legjislative:** Rimbursimi mbështetet jo vetëm te kjo direktivë, por edhe në direktiva të tjera të BE-së (92/83, 92/84, 2003/96, 2011/64).
- **Principi bazë:** Jep fleksibilitet shtetit anëtar për të përcaktuar rastet dhe kushtet, për sa kohë shmanget abuzimi.

Ligji 61/2012 – Nenet 13 dhe 14

Neni 13: Kërkesa për rimbursim ose shuarje

Përmbajtja:

- Përmbajtje e ngjashme me direktivën: Parashikon që akciza e paguar për mallra të çliruara për konsum mund të rimbursohet ose të shuhet, me kërkesë të personit të interesuar, nga autoritetet doganore, në situata të përcaktuara nga ligji dhe vendimet e Këshillit të Ministrave.
- Kushti: Duhet të zbatohen rregulla që parandalojnë evazionin dhe abuzimin.

Neni 14: Rimbursimi

Përmbajtja:

- **Specifikon rastet konkrete të rimbursimit**, të cilat janë më të hollësishme dhe të përcaktuara qartë, si:
 - a) procese të miratuara doganore,
 - b) eksporti i mallrave me akcizë të paguar në Shqipëri,
 - c) dëm i pullave të akcizës,
 - ç) përdorimi i karburanteve për prodhim energjie $\geq 5\text{M}\text{€}$,
 - d) karburant për sera dhe industri agroushqimore,
 - dh) biokarburantet e përdorura në transport (deri në 2020).
- **Kufizim:** Përjashtohen nga rimbursimi produktet e naftës të përdorura nga subjektet e kërkimit të naftës, pa marrë parasysh destinacionin.

KRAHASIMI

Elementi	Direktiva 2020/262 – Neni 10	Ligji 61/2012 – Nenet 13 & 14
Objekti i rimbursimit	Mallra të çliruara për konsum, me kërkesë të personit të interesuar	Po ashtu, mallra të çliruara për konsum – rimbursimi mund të kërkohet nga personi i interesuar
Kush i përcakton rastet?	Shtetet anëtare (me liri për të vendosur raste dhe kushte specifike)	Ligji dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave përcaktojnë situatat dhe procedurat
Qëllimi i kufizimeve	Parandalimi i abuzimit dhe evazionit	E njëjta logjikë – parandalimi i abuzimeve dhe evazionit të mundshëm
Specifikimi i rasteve	Jo i detajuar – le hapësirë shtetit anëtar të vendosë	Shumë i detajuar në nenin 14 – lista e rasteve të qarta për të cilat mund të bëhet rimbursimi

Elementi	Direktiva 2020/262 – Neni 10	Ligji 61/2012 – Nenet 13 & 14
Kufizime të veçanta	Nuk specifikon përjashtime të tilla si ndalimi për industrinë e naftës	Përjashton qartë nga rimbursimi produktet e naftës të përdorura nga subjektet e kërkimit të naftës
Subjektet përfitues	Personi i interesuar në mënyrë të përgjithshme	Në disa raste specifike: depozituesi i miratuar ose dërguesi i regjistruar (parashtrim para dërgimit të mallrave)

Përfundim

- **Direktiva 2020/262** ofron **parime të përgjithshme** për rimbursimin/shuarjen e akcizës dhe lë shtetet anëtare të përcaktojnë situatat e zbatimit.
- **Ligji shqiptar (nenet 13 dhe 14)** është në **përputhje të plotë me direktivën**, por shkon më tej duke **përcaktuar raste specifike** dhe rregulla të detajuara për përfitimin nga rimbursimi.
- Në thelb, **konceptet janë të njëjta**, por ligji shqiptar ka një **strukturë më të ngurtë dhe të sanksionuar në mënyrë taksative** në krahasim me fleksibilitetin që ofron direktiva për vendet anëtare të BE-së.

4.7 Krahasimi i Nenit 11 të Direktives 2020/262 me Nenin 10 të Ligjit Nr. 61/2012

Neni 11 i Direktivës (BE) 2020/262 – *Përjashtimet nga pagesa e akcizës*

Përmbajtja:

Ky nen përshkruan rregullat dhe kufizimet që lidhen me përjashtimet nga regjimi i përgjithshëm i pagesës së akcizës.

Pikat kyçe:

- Përjashtimet e mundshme nga pagesa e akcizës mund të japin mundësi për përdorimin e mallrave të akcizës pa taks, nëse mallrat janë të destinuara për:
 - Përdorim personal
 - Eksportim
 - Përdorim të veçantë, si në rastet e barnave për qëllime mjekësore
- Mallrat që përfitojnë nga këto përjashtime duhet të kalojnë një **proces të kontrolluar** dhe të dokumentuar, për të garantuar që nuk ka abuzime.
- Kufizimet specifike vendosen për:
 - Lëvizjen ndërmjet shteteve anëtare
 - Përdorimin e mallrave të prodhuara në kushte të caktuara (p.sh. për konsum personal ose për eksport).

□ Kjo dispozitë synon të sigurojë se përdorimi i mallrave të akcizës për qëllime të veçanta të kontrolluara nuk do të dëmtojë mbledhjen e të ardhurave dhe funksionimin e tregut të përbashkët.

Neni 10 i Ligjit Shqiptar nr. 61/2012 – *Rastet përjashtimore*

Përmbajtja:

Ky nen përshkruan përjashtimet nga pagesa e akcizës për disa lloje të caktuara mallrash.

Pikat kyçe:

- Përjashtimet nga pagesa e akcizës janë të përcaktuara për:
 - Mallrat që eksportohen jashtë Shqipërisë.
 - Mallrat që përdoren për qëllime të veçanta, si:
 - Përdorim personal.
 - Barnat dhe produktet farmaceutike.
 - Mallra të tjera të përcaktuara nga aktet nënligjore.
- Përdorimi i mallrave për përjashtime duhet të mbështetet në një procedurë të rregullt dhe raportim të vazhdueshëm.
- Përjashtimi nuk është automatik dhe kërkon kontroll dhe verifikim nga autoritetet doganore.

Ky nen synon të lejojë disa mundësi për përjashtimin nga pagesa e akcizës në rrethana të veçanta, të cilat mbahen nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore për të shmangur mundësitë e keqpërdorimit.

KRAHASIMI

Aspekti	Direktiva (BE) 2020/262 – Neni 11	Ligji shqiptar 61/2012 – Neni 10	Dallimi kryesor
Përjashtimet nga pagesa akcize	Rregullon përjashtimet për përdorim personal, eksport dhe përdorime të veçanta.	Përjashtimet për mallrat që eksportohen, përdoren për qëllime personale dhe farmaceutike.	BE ka më shumë mundësi përjashtimesh dhe ka një standardizim për përdorim ndërkombëtar.
Kontrolli dhe verifikimi	Kontroll i rreptë dhe i dokumentuar për çdo përjashtim dhe përdorim të veçantë.	Kontroll dhe verifikim nga autoritetet doganore në nivel kombëtar.	BE kërkon kontroll të centralizuar ndërmjet shteteve anëtare, Shqipëria e ka të lokalizuar.

Aspekti	Direktiva (BE) 2020/262 – Neni 11	Ligji shqiptar 61/2012 – Neni 10	Dallimi kryesor
Procedura për përjashtim	Procedura të detajuara dhe të harmonizuara ndërmjet shteteve anëtare të BE-së.	Procedura të specifikuar nga aktet nënligjore kombëtare dhe mbikëqyrje lokale.	BE vendos standarde të qarta ndërkombëtare, Shqipëria mbështetet në akte kombëtare.
Mallrat përjashtimi	Përjashtimet mund të përfshijnë një gamë më të gjerë produktesh, duke përfshirë lëvizjen ndër-shtetërore.	Përjashtimet janë të kufizuara, përqendrohen në eksport dhe përdorim të caktuar.	BE mbulon një gamë më të gjerë mallrash për lëvizje ndër-shtetërore.

Përmbledhje

- **Direktiva BE 2020/262** ofron një qasje të harmonizuar dhe të standardizuar për përjashtimet nga pagesa e akcizës, duke përfshirë mundësitë për lëvizjen ndërmjet shteteve anëtare dhe përdorimin ndërkombëtar.
- **Ligji shqiptar nr. 61/2012** fokusohet kryesisht në përjashtimet për përdorimin e brendshëm dhe ka një sistem kontrolli të orientuar nga autoritetet kombëtare.

4.8 Krahasimi ndërmjet nenit 12 të Direktivës 2020/262 dhe pikës 5 të nenit 10 të Ligjit Nr. 61/2012

Këto dispozita lidhen me dokumentacionin që shoqëron mallrat e akcizës që përfitojnë përjashtim nga detyrimi i akcizës – konkretisht, certifikatën/autorizimin e përjashtimit.

Direktiva 2020/262 – *Neni 12 Certifikata e përjashtimit nga akciza*

Përmbajtja:

- **Kërkesë për certifikatë:** Mallrat që lëvizin nga një shtet anëtar në tjetrin nën regjim pezullimi dhe që përfitojnë përjashtim nga akciza (sipas nenit 11) duhet të shoqërohen me një certifikatë përjashtimi.
- **Përmbajtja e certifikatës:** Duhet të përfshijë:
 - natyrën dhe sasinë e mallrave,
 - vlerën e tyre,
 - identitetin e përfituesit të përjashtuar,
 - shtetin anëtar pritës që certifikon përjashtimin.
- **Zgjerim i përdorimit:** Shtetet anëtare mund të përdorin këtë certifikatë edhe për tatime të tjera indirekte dhe të përshtatin përmbajtjen sipas ligjit të brendshëm.

- Komisioni Evropian: Do të miratojë akte zbatimi për të përcaktuar formatin standard të certifikatës.
- Përfshirje nga procedura standarde: Për lëvizjet që lidhen me forcat e armatosura (NATO), mund të përdoret një procedurë tjetër e veçantë, në vend të asaj të parashikuar në nenet 20–27.

Ligji 61/2012 – *Neni 10, pika 5 Autorizimi i përjashtimit nga akciza*

“Produktet e akcizës, objekt i trajtimit në këtë nen, do t’i nënshtrohen lëshimit të një autorizimi përjashtimi. Këshilli i Ministrave përcakton formën dhe përmbajtjen e autorizimit të përjashtimit.”

- Kërkesë ligjore: Për mallrat që përjashtohen nga akciza, është i detyrueshëm autorizimi i përjashtimit.
- Organ përcaktues: Këshilli i Ministrave përcakton formën dhe përmbajtjen e këtij dokumenti përjashtues.
- Funkcioni: Shërben si dokumentacion i kontrollit për të provuar të drejtën për përjashtim nga detyrimi i akcizës.

KRAHASIMI

Elementi	Direktiva 2020/262 – Neni 12	Ligji 61/2012 – Neni 10, pika 5
Emërtimi i dokumentit	Certifikatë përjashtimi (exemption certificate)	Autorizim përjashtimi
Përdorimi	Lëvizje ndërmjet shteteve anëtare nën regjim pezullimi, për mallra të përjashtuara	Mallra të përjashtuara nga akciza brenda territorit shqiptar
Përmbajtja	Përmbajtje e detajuar: natyra, sasia, vlera, përfituesi, shteti certifikues	Përmbajtja përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave
Funksioni	Provon të drejtën e përjashtimit dhe shoqëron mallrat gjatë lëvizjes	I njëjti funksion – vërteton të drejtën për përjashtim
Zgjerimi i përdorimit	Mund të përdoret edhe për tatime të tjera indirekte	Nuk përmendet zgjerim përdorimi – vetëm për akcizë
Përcaktuesi i formës	Komisioni Evropian (akte zbatimi)	Këshilli i Ministrave

Elementi	Direktiva 2020/262 – Neni 12	Ligji 61/2012 – Neni 10, pika 5
Përfshirje të veçanta	Për NATO, procedurë tjetër mund të përdoret në vend të asaj standarde	Nuk përmenden raste të veçanta (si NATO apo organizata ndërkombëtare)

Përfundim

- Të dyja aktet ligjore parashikojnë një dokument të detyrueshëm për përjashtimin nga akciza: certifikatë në BE dhe autorizim në Shqipëri.
- Dallimi kryesor qëndron në përmbajtjen dhe përcaktimin e formës së dokumentit:
 - Në BE është e standardizuar në nivel komunitar (Komisioni përcakton formatin),
 - Në Shqipëri, forma përcaktohet në mënyrë autonome nga Këshilli i Ministrave.
- Direktiva ka një aplikim më të gjerë në lëvizjet ndërkombëtare dhe përfshin edhe rastet ushtarake dhe përdorime tatimore shtesë.

4.9 Krahësimi ndërmjet nenit 13 të Direktivës 2020/262 dhe nenit 12 të Ligjit Nr. 61/2012

Ky krahasim tregon përputhshmëri të qartë në trajtimin e përjashtimeve nga akciza për mallrat që lëvrohen nga duty free shops dhe merren nga udhëtarët që udhëtojnë jashtë territorit kombëtar.

Direktiva 2020/262 – Neni 13 Përjashtimi nga akciza për udhëtarët që udhëtojnë drejt vendeve të treta ose territoreve të treta

Përmbajtja:

